ALBAVIA

ASAMBLEJA E ORTAKEVE SHOQERISE
ALBAVIA SH.P.K.

ALBAVIA sh.p.k është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me kapital të rregjistruar 135.300.000 lekë, i ndarë në 1,650 kuota me vlerë 82,000 lekë/kuote, tërësisht i paguar, me adresë të regjistruar në Tiranë,Rruga Sulejman Delvina,Pallati. Fati, shk.1,ap.19 rregjistruar pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit ("**QKB**"), me NUIS J81527001Q, me administrator Z. Shkëlqim Rakipaj dhe Z. Hasan Hafizi (referuar më poshtë si **"ALBAVIA"** ose "**Shoqëria**").

Data:15.12.2020

Vendi: Tiranë

Rendi i Dites:

1. Miratimi i Bashkimit me Përthithje të Shoqërise "EMULIV" sh.p.k nga shoqëria "ALBAVIA "Sh.p.k.
2. Miratimi i Marrëveshjes së Bashkimit me Përthithje të "EMULIV" sh.p.k nga shoqëria "ALBAVIA" Sh.p.k.
3. Miratimin e Raportit të Administratoreve mbi Bashkimin me Përthithje.
4. Miratimi i Raportit te Audituesit Ligjor per vleresimin e Bashkimit me perthithje.
5. Miratimi i ndryshimeve ne Statutin e shoqerise si rezultat i rritjes se Kapitalit te shoqerise "ALBAVIA" sh.p.k nga bashkimi.
6. Të ndryshme.

Asambleja e Pergjithshme e Shoqerise perbehet nga Ortaket e Shoqerise si me poshte:

- Z. Hasan Hafizi zoterues i 52% te kapitalit te shoqerise,
- Z. Shkëlqim Rakipaj zoterues i 48% te kapitalit te shoqerise,

DUKE QENE SE:

(i) Ortaket e Shoqërisë mund të marrin cdo vendim që është në kompetencë të Asamblesë së Pergjithshme të Shoqërise, në përputhje me dispozitat e zbatueshme të Statutit dhe Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar ("**Ligji Tregtar**");

(ii) Ortaket jane duke vendosur mbi cështjet e specifikuara në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe cdo akt në fuqi të shoqërisë;

(iii) Ortaket e shoqerise, përmes nënshkrimit të këtij vendimi, shpreh miratimin e tij mbi daten e mbledhjes dhe mbi rendin e dites;

ALBAVIA

KUSHTET PARAPRAKE:

(A) Me datë 26.10.2020, administratoret e Shoqërisë "ALBAVIA" sh.p.k z. Hasan Hafizi dhe z. Shkëlqim Rakipaj që është njëkohësisht edhe administrator i Shoqërise "EMULIV" sh.p.k kane vendosur të fillojne procedurat e transaksionit të bashkimit të Shoqërise "EMULIV" sh.p.k me shoqerine "ALBAVIA" sh.p.k , përmes përthithjes së "EMULIV" sh.p.k nga "ALBAVIA" sh.p.k **("Bashkimi" ose "Bashkimi me Përthithje")**, me anë të nënshkrimit të Projektmarrëveshjes së Bashkimit me Përthithje **("Projektmarreveshja e Bashkimit me Perthithje" ose "Projektmarrëveshja")**.

(B) Administratoret dhe Ortaket e shoqerise "ALBAVIA"sh.p.k., z.Hasan Hafizi dhe z.Shkëlqim Rakipaj jane autorizuar nga Asambleja e Ortakeve e të dy shoqërive të përgatisin dhe publikojne Projektmarrëveshjen e Bashkimit me Përthithje.

(C) Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë "ALBAVIA" sh.p.k ka miratuar në parim Bashkimin me Përthithje të Shoqërise "EMULIV" sh.p.k me "ALBAVIA" sh.p.k, përmes përthithjes së "EMULIV" sh.p.k nga "ALBAVIA" sh.p.k

(D) Ortaket e Shoqerisë "ALBAVIA" sh.p.k me anën e kësaj mbledhjeje synojne të miratojne procedurat e bashkimit si edhe të miratojne Marrëveshjen e Bashkimit me Përthithje.

PER SA ME SIPER, ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE

VENDOSI:

1. Miratimin e Bashkimit me Përthithje të Shoqërise "EMULIV" sh.p.k nga "ALBAVIA" sh.p.k.;
2. Miratimin e Marrëveshjes së Bashkimit me Perthithje (bashkëlidhur si Aneksi 1);
3. Miratimin e Raportit te Administratorit mbi Bashkimin me Përthithje (bashkëlidhur si Aneksi 2);
4. Miratimin e Raportit te Auditimit te shoqerise I.L.D-99 AUDIT sh.p.k për vlerësimin e Bashkimit me Përthithje të Shoqërisë "EMULIV" sh.p.k nga shoqëria "ALBAVIA" sh.p.k.;
5. Miratimin e ndryshimeve ne statutin e shoqerise "ALBAVIA" sh.p.k per pjesen e kapitalit themeltar si me poshte:

   Si rezultat i operacionit të bashkimit, Kapitali i Shoqërisë "ALBAVIA" sh.p.k do te rritet me shumën 150,000 lekë, që i përket shumës së Kapitalit të Shoqërise "EMULIV" sh.p.k në datën e bashkimit.

ALBAVIA

Mbas rritjes Kapitali i Shoqerise "ALBAVIA" sh.p.k nga 135,300,000 leke rritet edhe me 150,000 leke dhe bëhet 135,450,000 lekë dhe numri i kuotave behet 2 kuota dhe zoterimi i tyre do te jete respektivisht:

- **Z. Hasan Hafizi do te zotroje nje kuote me vlere 70,434,000 leke ose 52% te kapitalit**
- **Z. Shkëlqim Rakipaj do te zotroj nje kuote me vlere 65,016,000 leke ose 48% te kapitalit.**

6. Autorizimin e Administratoreve të Shoqërise "ALBAVIA" sh.p.k, të kryejne cdo veprim për zbatimin e këtij vendimi;

Anekset:

Aneksi 1: Marrëveshja e Bashkimit me Përthithje
Aneksi 2: Raporti i Administratoreve mbi Bashkimin me Përthithje
Aneksi 3:Raporti i Audituesit Ligjor per vleresimin e Bashkimit me perthithje.
Aneksi 4: Vendimi i Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të "EMULIV" Sh.p.k.,

ORTAKET E SHOQERISE

Hasan Hafizi

Shkëlqim Rakipaj

ALBAVIA
ALBAVIA Shpk.
NUT J81527001Q

EMULIV SHPK

VENDIM I ASAMBLESE SE ORTAKEVE
TE
SHOQERISE
EMULIV SH.P.K.

"EMULIV" sh.p.k është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me kapital të rregjistruar 150,000 lekë, i ndarë në 2 kuota me vlerë 75,000 lekë, tërësisht i paguar, me adresë të regjistruar ne Kamez,Lagjja nr.4, numer pasurie 47/49, (prane Argjinatures), rregjistruar pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit ("**QKB**"), me NUIS K11821005V, me administrator Z. Shkëlqim Rakipaj (referuar më poshtë si " **EMULIV** " ose "**Shoqëria**").

Data: 15.12. 2020
Vendi: Tiranë

Rendi i Ditës:

1. Miratimi i Bashkimit me Përthithje të Shoqërisë "EMULIV" sh.p.k nga shoqëria "ALBAVIA" Sh.p.k.
2. Miratimi i Marrëveshjes së Bashkimit me Përthithje të "EMULIV" sh.p.k nga shoqëria "ALBAVIA" Sh.p.k.
3. Miratimin e Raportit të administratorit mbi Bashkimin me Përthithje.
4. Miratimin e çrregjistrimit pa likujdim te shoqerise "EMULIV" sh.p.k
5. Të ndryshme.

Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë përbëhet nga ortaket e Shoqërisë si më poshtë:

- **Z. Hasan Hafizi zoterues i 50% te kapitalit te shoqerise**
- **Z. Shkëlqim Rakipaj zoterues i 50% te kapitalit te shoqerise**

DUKE QENE SE:

(i) Asambleja e Ortakeve te shoqërisë mund të marr cdo vendim që është në komptencë të Asamblesë së Pergjithshme të Shoqërise, në përputhje me dispozitat e zbatueshme të Statutit dhe Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar ("**Ligji Tregtar**");

(ii) Asambleja e Ortakeve te shoqërisë është duke vendosur mbi cështjet e specifikuara në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe cdo akt në fuqi të shoqërisë;

(iii) Ortaket e shoqerise,përmes nënshkrimit të këtij vendimi, shprehin miratimin e tyre mbi daten e mbledhjes dhe mbi rendin e dites;

EMULIV SHPK

KUSHTET PARAPRAKE:

(A) Më datë 26.10.2020, administratori i Shoqërisë "EMULIV"sh.p.k Z. Shkëlqim Rakipaj që është njëkohësisht edhe bashkeadministrator i Shoqërisë ALBAVIA sh.p.k ka vendosur të filloj procedurat e transaksionit të bashkimit të Shoqërisë "EMULIV" sh.p.k me "ALBAVIA" sh.p.k, përmës përthithjes së "EMULIV" sh.p.k nga "ALBAVIA" sh.p.k **("Bashkimi" ose "Bashkimi me Përthithje")**, me anë të nënshkrimit të Projektmarrëveshjes së Bashkimit me Përthithje **("Projektmarreveshja e Bashkimit me Perthithje" ose "Projektmarrëveshja")**.

(B) Administratori i shoqerise "EMULIV" sh.p.k Z. Shkëlqim Rakipaj është autorizuar nga Asmableja e Ortakeve e të dy shoqërive të përgatisë dhe publikoj Projektmarrëveshjen e Bashkimit me Përthithje.

(C) Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë "EMULIV" sh.p.k ka miratuar në parim Bashkimin me Përthithje të Shoqërise "EMULIV" sh.p.k me "ALBAVIA" sh.p.k , përmes përthithjes së "EMULIV" sh.p.k nga "ALBAVIA" sh.p.k

(D) Ortaket e Shoqerisë "EMULIV" sh.p.k me anën e kësaj mbledhjeje synon të miratojne bashkimin si edhe të miratojne Marrëveshjen e Bashkimit me Përthithje.

PER SA ME SIPER, ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE VENDOSI:

1. Miratimin e Bashkimit me Përthithje të Shoqërise "EMULIV" sh.p.k nga "ALBAVIA" sh.p.k.;

2. Miratimin e Marrëveshjes së Bashkimit me Perthithje (bashkëlidhur si Aneksi 1);

3. Miratimin e Raportit te Administratorit mbi Bashkimin me Përthithje (bashkëlidhur si Aneksi 2);

4. Miratimin e çrregjistrimit pa likujdim te shoqerise "EMULIV" sh.p.k

5. Autorizimin e Administratorit të Shoqërise "EMULIV" sh.p.k, Z. Shkëlqim Rakipaj të kryej cdo veprim për zbatimin e këtij vendimi.

EMULIV SHPK

Anekset:

Aneksi 1: Marrëveshja e Bashkimit me Përthithje dhe anekset e saj
Aneksi 2: Raporti i Administratorit mbi Bashkimin me Përthithje
Aneksi 3: Vendimi i Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të "ALBAVIA" Sh.p.k.,

ORTAKET E SHOQERISE

Hasan Hafizi Shkëlqim Rakipaj

EMULIV sh.p.k.
RR. "VASO PASHA" PALL. 26
KODI FISKAL: 3709130
NIPT: K11821005V
TIRANE

MARRËVESHJE E BASHKIMIT ME PËRTHITHJE

Ndërmjet

ALBAVIA sh.p.k
Si Shoqëri Përthithëse

Dhe

EMULIV sh.p.k
Si Shoqëri e Përthithur

ALBAVIA SH.P.K EMULIV SH.P.K

a. ALBAVIA SH.P.K - Nr. _____ Prot. Tiranë, më 14/12/ 2020

b. EMULIV SH.P.K - Nr. _____ Prot. Tiranë, më 14/12/ 2020

MARRVESHJE BASHKIMI ME PËRTHITHJE

Kjo Marrveshje bashkimi me përthithje është hartuar nga:

- **Administratorët e shoqërisë ALBAVIA sh.p.k , Z. Shkëlqim Rakipaj dhe Z. Hasan Hafizi**
- **Administratori i shoqërisë EMULIV sh.p.k, Z.Shkëlqim Rakipaj**

Ky projekt për realizimin e procesit të bashkimit me përthithje të EMULIV sh.p.k nga ALBAVIA sh.p.k është iniciuar nga ortaket e te dy shoqërive z.Shkëlqim Rakipaj dhe z.Hasan Hafizi.

ALBAVIA sh.p.k është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me kapital të regjistruar 135,300,000 lekë, i ndarë në 1,650 kuota, tërësisht i paguar, me adresë të rregjistruar në Tiranë, Rruga Sulejman Delvina,Pallati. Fati,shk.1,ap.19 e përfaqësuar nga administratoret ligjor te shoqërisë Z. Shkëlqim Rakipaj dhe Z. Hasan Hafizi, që për qëllim të kësaj marrëveshje ALBAVIA sh.p.k do të quhet **"Shoqëria Përthithëse".**

Dhe

EMULIV sh.p.k shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me kapital themltar të rregjistruar 150,000 lekë, tërësisht i paguar, me adresë të rregjistruar në Kamez, Lagjja nr.4, numer pasurie 47/49, (prane Argjinatures) i përfaqësuar nga administratori ligjor i shoqërisë Z. Shkëlqim Rakipaj, për qëllim të kësaj marrëveshje EMULIV do të quhet "**Shoqëria e Përthithur".**

Ortak të të dy shoqërive jane Z. Shkëlqim Rakipaj dhe Z. Hasan Hafizi ku zotrimi i kapitalit te shoqeria Albavia eshte Hasan Hafizi zoteron 52% te kapitalit dhe Shkëlqim Rakipaj zoteron 48% te kapitalit, kurse te shoqeria EMULIV sh.p.k zoterimi i kapitalit eshte 50% me 50% te kapitalit.

DEKLARATA PARAPRAKE

A. Në përputhje me Ligjin Nr. 9901 datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Pjesa IX, Neni 215 deri tek Neni 225, me propozim të ortakeve të të dy shoqërive hartohet kjo marrëveshje për bashkimin me përthithje të të EMULIV sh.p.k nga ALBAVIA sh.p.k.

B. Duke qënë se të dy shoqërite ALBAVIA sh.p.k dhe EMULIV sh.p.k zotërohen në masën 100% të kapitalit nga te dy ortaket Z. Shkëlqim Rakipaj dhe Z. Hasan Hafizi,

C. Me qëllim përmirësimin e performancës ekonomike të Shoqërisë " ALBAVIA" sh.p.k në përputhje me objektivat e Shoqërisë, si edhe uljet e kostove administrative nëpërmjet përthithjes së EMULIV sh.p.k nga ALBAVIA sh.p.k, e cila do të përmirësojnë flukset e parasë .

D. ALBAVIA sh.p.k dhe EMULIV sh.p.k dëshirojnë të kryejnë një bashkim nëpërmjet të cilit ALBAVIA sh.p.k do të përthith shoqërinë EMULIV sh.p.k dhe shoqëria ALBAVIA sh.p.k do të vazhdoje aktivitetin kurse EMULIV sh.p.k do të çrregjistrohet pa kaluar në likujdim.

E. **Me Vendimin datë 26/10/2020 të Ortakeve të shoqërisë ALBAVIA sh.p.k** është miratuar: Fillimi i procedurave për bashkimin nëpërmjet përthithjes të shoqërisë ALBAVIA sh.p.k me shoqërine EMULIV sh.p.k dhe janë ngarkuar administratorët e shoqërisë për ndjekjen e procesit dhe përgatitjen e dokumentave të Bashkimit me Përthithje.

F. **Me Vendimin datë 26/10/2020 të Ortakeve të shoqërisë EMULIV sh.p.k** është miratuar: Fillimi i procedurave për bashkimin nëpërmjet përthithjes të shoqërisë EMULIV sh.p.k me shoqërine ALBAVIA sh.p.k dhe është ngarkuar administratori i shoqërisë për ndjekjen e procesit dhe përgatitjen e dokumentave të Bashkimit me Përthithje.

G. Dy shoqëritë kanë rënë dakord për të **hartuar Projektmarrëveshjen date 19/10/2020 në mënyrë** që të përcaktojnë afatet dhe kushtet e të drejtave dhe të detyrimeve respektive në përputhje me procesin e bashkimit.

H. Dy shoqëritë kanë rënë dakord për të shenderruar **Projektmarrëveshjen date 19/10/2020 ne MARRVESHJE ne date 14/12/2020 në mënyrë** që të përcaktojnë afatet dhe kushtet e të drejtave dhe të detyrimeve respektive në përputhje me procesin e bashkimit.

Të dyja shoqëritë kanë rënë dakord si mëposhtë vijon:

Neni 1

PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIME

Në këtë Marrëveshje, përvecse kur kuptohet ndryshe ose kur cilësohet ndryshe më tej, fjalët e mëposhtme do të kenë kuptimet e mëposhtme:

"Shoqëri Përthithese" në Marrëveshje do të thotë shoqëria ALBAVIA sh.p.k

"Shoqëri e Përthithur" në Marrveshje do të thotë shoqëria EMULIV sh.p.k

"Data e Realizimit Përfundimtar të Bashkimit" (Data Efektive e Bashkimit) do të thotë data e miratimit të Marrëveshjes nga Ortaket e shoqërive ALBAVIA sh.p.k dhe EMULIV sh.p.k dhe e depozitimit të këtyre dokumentave në Qëndrën Kombëtare të Biznesit në perputhje me nenin 220, paragarfi 3 i Ligjit Tregetar.

"Data e Bashkimit" ka kuptimin që i është dhënë në piken 1.4 që do të thotë data 01/01/2020.

"Periudha Kalimtare" do te thotë periudha kohore nga data e miratimit nga ortaket e të dy shoqërive të Bashkimit, deri në mbyllje gjatë së cilës shoqëritë ALBAVIA sh.p.k dhe EMULIV sh.p.k do të kryejnë një tërësi veprimesh me qëllim përmbushjen e transaksionit te Bashkimit me Përthithje.

"Marrëveshje" nënkupton këtë marrëveshje.

"Data e nënshkrimit" nënkupton datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje nga të dyja palet, ashtu sic tregohet në faqet e nënshkruara të kësaj marrëveshje.

Neni 2

BASHKIMI, KËMBIMI I AKSIONEVE

2.1 Në bazë të kushteve të Marrëveshjes Albavia sh.p.k do të përthithë Shoqërinë Emuliv sh.p.k në Datën e Realizimit Përfundimtar të Bashkimit (Data Efektive e Bashkimit) që është data e miratimit të marrëveshjes nga ortaket e Shoqërive ALBAVIA sh.p.k dhe EMULIV sh.p.k dhe i depozitimit të këtyre dokumentave në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

2.2 Bashkimi me Përthithje bazohet në Pasqyrat Financiare të ALBAVIA sh.p.k të datës 31.12.2019 dhe EMULIV sh.p.k te dates 31.12.2018 mbasi per vitin 2019 nuk ka patur pasqyra fiananciare dhe nuk ka ushtruar aktivitet, e cila është edhe Data e Fundit Kontabël.

2.3 EMULIV sh.p.k do t'i trasferojë Shoqërisë ALBAVIA sh.p.k tërësinë e elementeve të aktivit e të pasivit deri në Datën Efektive të Mbylljes se Bashkimit.

2.4 Si rezultat i operacionit të bashkimit, Kapitali i Shoqërisë ALBAVIA sh.p.k në Datën Efektive të Mbylljes do te rritet me shumën 150,000 lekë, që i përket shumës së Kapitalit të Shoqërise EMULIV sh.p.k në datën e bashkimit. Mbas rritjes Kapitali i Shoqerise ALBAVIA sh.p.k bëhet 135,450,000 lekë dhe numri i kuotave behet 2 kuota dhe zoterimi i tyre do te jete respektivisht:

- **Z. Hasan Hafizi do te zoteroje nje kuote me vlere 70,434,000 leke**
- **Z. Shkëlqim Rakipaj do te zoteroj nje kuote me vlere 65,016,000 leke**

2.5 Data e Bashkimit është data 01.01.2020, që do të thotë që, të gjitha dhe çdo operacion i kryer nga EMULIV sh.p.k që nga data 01 Janar 2020 deri në Datën e rregjistrimit përfundimtar në Qendrën Kombëtare të Bisnesit (QKB) do të konsiderohen si të kryera nga ALBAVIA sh.p.k.

2.6 Bilanci i Hapjes së Shoqërise Përthithëse në datën e bashkimit do të jetë bilanci i konsoliduar i të dy shoqërive para perthithjes në datë 31.12.2019 (Data e Fundit Kontabël). Cdo ndryshim dhe korrigjim i mundshëm i kryer midis Dates së Fundit Kontabël dhe datës së mbylljes do të reflektohet në Marreveshjen Përfundimtare të Bashkimit.

2.7 Statuti i Shoqërisë ALBAVIA sh.p.k do të vazhdojë të jetë edhe Statuti i Shoqërisë Përthithese.

2.8 Anëtarët e organeve drejtuese të Shoqërisë ALBAVIA sh.p.k në datën e mbylljes do të vazhdojnë të jenë anëtarët e organeve të Shoqërisë Përthithëse.

2.9 Administratoret e shoqërisë Përthithëse do vazhdojn të jene Z. Shkëlqim Rakipaj dhe Z. Hasan Hafizi te cilet do të ushtrojnë kompetencat e administrimit të shoqërisë së bashkuar sipas ligjit dhe statutit të shoqërisë, gjithashtu Vanina Latifi do te vazhdoje te jete Administrator vetem per ceshtjet mjedisore.

Neni 3

EKSPERTËT

Me qëllim vlerësimin e kushteve të Projektmarrëveshjes të bashkimit, për të dyja shoqëritë pjesëmarrëse në këtë procedure Bashkimi me Përthithje, emërohet shoqeria I.L.D-99 Audit sh.p.kk me Partnere Angazhimi z.Luan KAMBERI,i biri i Musait, i dtl. 23 Shkurt 1965, banuese në Tiranë, shtetas shqiptar, Auditues Ligjor, anëtare i IEKA, mbajtëse i licencës me nr.40, dt. 13/01/2000.

Audituesi ngarkohet sipas ligjit të hartojë një raport me shkrim, nëpërmjet të cilit do të deklarojë dhe vlerësoj kapitalin e shoqërive.

Kapitali i Shoqërisë Përthithëse, (shoqërisë përfituese të kontributeve), pas realizimit të procesit të Bashkimit me Përthithje me shoqërinë "EMULIV" sh.p.k (shoqëria kontribuese), do të përbëhet nga shuma e kapitaleve të secilës prej shoqërive në momentin e realizimit të këtij procesi, vlerë e cila do të përcaktohet me paraqitjen nga Audituesi Ligjor të raportit për modalitetet e bashkimit dhe vlerësimin e kapitaleve të dy shoqërive.

Shoqëritë pjesëmarrëse në këtë proces Bashkim me Përthithje, garantojnë sipas ligjit së ekspertit do ti vihet në dispozicion i gjithë informacioni dhe dokumentat përkatëse, me qëllim kryerjen e të gjitha hetimeve të nevojshme.

Neni 4

AKTIVET DHE DETYRIMET PËR TU TRANSFERUAR

Në kuadrin e këtij operacioni bashkimi parashikohet që EMULIV sh.p.k t'ia transferojë shoqërisë ALBAVIA sh.p.k tërësinë e elementëve të aktivit e të pasivit gjendje më datë 31.12. 2018 si me poshte:

EMULIV SH.P.K

Pasqyra e Pozicionit Financiar

Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 Dhjetor 2018		31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
në LEK			
Mjete monetare	4	784,545	927,113
Investime		-	-
Llogari të arkëtueshme tregëtare	5	17,476,599	17,476,599
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	45,968,028	46,074,318
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	1,125,611	1,135,611
Inventari		-	-
Shpenzime të shtyra		-	-
Aktive tatimore të shtyra		-	-
Total Aktive Afatshkurtra		**65,354,783**	**65,613,641**
Aktivet afatgjata			
Aktive financiare		-	-
Aktive afatgjata materiale	8	581,006	726,533
Aktive afatgjata jomateriale		-	-
Aktive tatimore të shtyra		-	-
Total aktive afatgjata		**581,006**	**726,533**
Total Aktive		**65,935,788**	**66,340,174**
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra		-	-
Llogari të pagueshme tregëtare	9	8,459,852	8,459,852
Llogari të pagueshme nga palët të lidhura	10	7,354,348	7,354,348
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		-	-
Detyrime tatimore	11	5,000	6,020
Të ardhurat e shtyra		-	-
Provizione		-	-
Të tjera detyrime	12	3,482,590	3,364,630
Total Detyrime afatshkurtra		**19,301,790**	**19,184,850**
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata		-	-
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		-	-
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	13	28,877,955	28,752,231
Të ardhurat të shtyra		-	-
Provizione		-	-
Detyrime tatimore të shtyra		-	-
Total Detyrime afatgjata		**28,877,955**	**28,752,231**
Totali i detyrimeve		**48,179,745**	**47,937,081**
Kapitali aksionar	14		
Kapitali i nënshkruar		150,000	150,000
Primi i lidhur me kapitalin		-	-
Rezerva rivleresimi		-	-
Rezerva ligjore		15,000	15,000
Rezerva të tjera		18,238,093	18,704,690
Fitimi i ushtrimit		(647,050)	(466,597)
Total kapitali aksionar		**17,756,043**	**18,403,093**
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		**65,935,788**	**66,340,174**

Ndërkohë të dhënat e bilancit të **ALBAVIA sh.p.k** më datë 31 Dhjetor 2019 që janë marre si bazë për hartimin e Marrëveshjes së bashkimit janë si më poshtë:

Pasqyra e Pozicionit Financiar	Shënime	31 dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	19,588,950	80,539,270
Llogari të arkëtueshme tregëtare	5	518,365,319	397,506,194
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	542,410,074	569,929,078
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	23,863,242	25,515,452
Inventarë	8	51,541,909	53,481,178
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	9	90,068,609	230,941,644
Total Aktive Afatshkurtra		**1,245,838,103**	**1,357,912,816**
Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	10	573,502,447	540,499,658
Llogari të arkëtueshme afatgjata	11	72,125,476	51,554,029
Total aktive afatgjata		**645,627,923**	**592,053,687**
Total aktive		**1,891,466,026**	**1,949,966,503**
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	12	597,195,612	553,642,188
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	13	120,149,221	134,520,734
Detyrime tatimore	14	1,683,457	4,399,649
Të tjera detyrime	15	7,505,556	9,393,048
Paradhënie	16	-	6,724,578
Total Detyrime afatshkurtra		**726,533,846**	**708,680,197**
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	17	325,676,212	283,067,711
Paradhënie e të ardhurat e shtyra	18	173,210,415	325,674,474
Llogari të pagueshme afatgjata	19	282,022,437	215,935,958
Total detyrime afatgjata		**780,909,064**	**824,678,143**
Totali i detyrimeve		**1,507,442,910**	**1,533,358,340**
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar		135,300,000	135,300,000
Rezerva ligjore		15,281,127	13,700,277
Rezerva të tjera		230,946,545	235,965,889
Rezerva statutore		25,006	25,006
Fitimi i ushtrimit		2,470,438	31,616,991
Total kapitali	20	**384,023,116**	**416,608,163**
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		**1,891,466,026**	**1,949,966,503**

Mbas realizimit të operacionit të bashkimit të dhënat e bilancit të **Albavia sh.p.k më datë 01.01.2020** mbas bashkimit me përthithje paraqiten si më poshtë:

Pasqyra e Pozicionit Financiar

Më 31 dhjetor 2019

Pasqyra e Pozicionit Financiar	Shënime	31 dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	20,373,495	80,539,270
Llogari të arkëtueshme tregëtare	5	535,841,918	397,506,194
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	540,986,473	569,929,078
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	24,988,853	25,515,452
Inventarë	8	51,541,909	53,481,178
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	9	90,068,609	230,941,644
Total Aktive Afatshkurtra		**1,263,801,257**	**1,357,912,816**
Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	10	574,083,453	540,499,658
Llogari të arkëtueshme afatgjata	11	72,125,476	51,554,029
Total aktive afatgjata		**646,208,929**	**592,053,687**
Total aktive		**1,910,010,186**	**1,949,966,503**
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	12	605,655,464	553,642,188
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	13	80,111,941	134,520,734
Detyrime tatimore	14	1,688,457	4,399,649
Të tjera detyrime	15	7,505,556	9,393,048
Paradhënie	16	3,482,590	6,724,578
Total Detyrime afatshkurtra		**698,444,008**	**708,680,197**
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	17	325,676,212	283,067,711
Paradhënie e të ardhurat e shtyra	18	173,210,415	325,674,474
Llogari të pagueshme afatgjata	19	282,022,437	215,935,958
Total detyrime afatgjata		**780,909,064**	**824,678,143**
Totali i detyrimeve		**1,508,231,027**	**1,533,358,340**
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar		135,450,000	135,300,000
Rezerva ligjore		15,296,127	13,700,277
Rezerva të tjera		249,184,638	235,965,889
Rezerva statutore		25,006	25,006
Fitimi i ushtrimit		1,823,388	31,616,991
Total kapitali	20	**401,779,159**	**416,608,163**
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		**1,910,010,186**	**1,949,966,503**

Neni 5

MODALITETET

5.1 **ALBAVIA sh.p.k** do të jetë zotëruese e të gjitha aktiveve dhe pasiveve të Shoqërisë **EMULIV** sh.p.k në datën Efektive të Bashkimit.

5.2 **ALBAVIA sh.p.k** në datën Efektive te Bashkimit do të zotërojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e zotëruara nga **EMULIV sh.p.k** në këtë datë.

5.3 Punonjësit e shoqërisë **EMULIV sh.p.k** do të përfshihen mbas datës së bashkimit si punonjës tek shoqeria **ALBAVIA sh.p.k.**

Neni 6

GARANCITË PËR KREDITORËT DHE MBROJTJA E TYRE

6.1 Palët në këtë procedurë Bashkimi me Përthithje të shoqërive të mësipërme, garantojne kreditorët e shoqërive të përfshira në këtë bashkim, sidomos ata të Shoqërisë së Përthithur se megjithëse debitori fillestar humbet (pra shoqëria e përthithur), detyrimet e saj sipas ligjit i transferohen shoqërisë përthithese "**ALBAVIA " sh.p.k** .

6.1 Shoqëria përthithese ("**ALBAVIA " sh.p.k**) merr përsipër sipas ligjit të bëhet pasardhëse e shoqërisë së përthithur (**EMULIV sh.p.k**) në marrëdhënie me të tretet, duke garantuar në këtë mënyrë kreditorët e shoqërisë së përthithur ti drejtojnë pretendimet e tyre ndaj shoqërisë përthithese.

Neni 7

DATA KONTABËL

Në aspektin e kontabilitetit të gjitha operacionet e veprimtarisë të kryera prej shoqërisë "**EMULIV" sh.p.k** nga data 1 Janar 2020 deri në datën e rregjistrimit përfundimtar të procesit të bashkimit pranë QKB-së, datë në të cilin do të ndodhi çregjistrimi pa likujdim i shoqërisë "**EMULIV" sh.p.k**, do të konsiderohen si të kryera nga shoqëria përthithese "**ALBAVIA " sh.p.k** dhe rregjistrimet kontabël përkatëse do të merren në librat e saj.
Duke qënë se data mbi të cilën do të bëhet bashkimi është data 31 Dhjetor 2019 bilanci përfundimtar i përthithjes do të jetë bilanci i të dy shoqërive i datës 31.12.2019.

Neni 8

DATA E PËRGATITJES (HARTIMIT) TË LLOGARIVE

Llogaritë që janë përdorur për të përcaktuar kushtet financiare të bashkimit për këtë projekt Bashkimi me Përthithje, janë hartuar duke u referuar datës 31.12.2019 per shoqerine "**ALBAVIA " sh.p.k** dhe dates 31.12.2018 per shoqerine si për shoqërinë e përthithur " **EMULIV" sh.p.k,** duke qene se kjo shoqeri gjate vitit 2019 nuk ka ushtruar aktivitet ekonomik.

Neni 9

RAPORTET E KEMBIMIT

Duke konsideruar që "**ALBAVIA " sh.p.k** dhe " **EMULIV" sh.p.k**, zotërohen 100% nga te njejtet ortak, respektivisht "**ALBAVIA " sh.p.k zotrohet nga :**

- Z. Hasan Hafizi zotron 52% te kapitalit,
- Z. Shkëlqim Rakipaj zotron 48% te kapitalit te shoqerise "Albavia" sh,p,k

Kurse shoqeria "**EMULIV" sh.p.k** aktualisht zotrohet nga te dy ortaket e mesiperm ne raportet 50% me 50% te kuotave te kapitalit.
Nga perthithja eshte rene dakort midis ortakeve qe raportet e këmbimit të kapitalit te shoqerise "EMULIV" sh.p.k te jene raportet e kapitalit te shoqerise "ALBAVIA " sh.p.k pra 52% Z.Hasan Hafizi dhe 48% Z. Shkëlqim Rakipaj.

Si rezultat i operacionit të bashkimit, Kapitali i Shoqërisë Albavia sh.p.k në Datën Efektive të Mbylljes do te rritet me shumën 150,000 lekë, që i përket shumës së Kapitalit të Shoqërise Emuliv sh.p.k në datën e bashkimit. Mbas rritjes Kapitali i Shoqerise ALBAVIA sh.p.k bëhet 135,450,000 lekë dhe numri i kuotave behet 2 kuota dhe zotrimi i tyre do te jete respektivisht:

- Z. Hasan Hafizi do te zotroje nje kuote me vlere 70,434,000 leke ose 52% te kapitalit
- Z. Shkëlqim Rakipaj do te zotroj nje kuote me vlere 65,016,000 leke ose 48% te kapitalit.

Neni 10

SHUMA E PARASHIKUAR E PRIMIT TË BASHKIMIT

Nga operacioni i mësipërm nuk do të rezultojë prim nga bashkimi.

Neni 11

TË DREJTA DHE AVANTAZHE TË VEÇANTA

Ky operacion bashkimi nuk do të përmbajë as të drejta dhe as ndonjë avantazh të veçantë.

Neni 12

PREMTIME DERI NË MBYLLJE

Deri në datën e mbylljes, Palët duhet që:

a) të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të miratuar dhe autorizuar Marrëveshjen e Bashkimit si dhe dokumentat e tjera në lidhje me to.
b) të ndërmarrin çdo veprim për depozitim të të gjitha dokumentave në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Neni 13

MBYLLJA E OPERACIONIT

10.1.Mbyllja e operacionit të bashkimit do të bëhet në selinë e shoqërisë "Albavia" sh.p.k në adresën: Tiranë, Rruga Sulejman Delvina,Pallati. Fati, shk.1,ap.19.

10.2. Në mbyllje, ose para saj palët duhet të kenë bërë të mundur realizimin dhe dorezimin e dokumentave të mëposhtme:

a) Të gjithë vendimet e Asamblese se Ortakeve në lidhje me këtë operacion.
b) Njoftimet përkatëse në zyrat e taksave në lidhje me operacionin e mësipërm.
c) Kalimin e punonjësve nga Shoqëria e Përthithur në shoqërinë përthithëse

Neni 14

DEKLARIMET DHE GARANCITE

*Deklarimet dhe Garancitë e "*ALBAVIA*" sh.p.k:*

- "ALBAVIA" sh.p.k dhe përfaqesuesit e saj kan të gjithë fuqinë dhe autoritetin e kërkuar për të kryer këtë marrëveshje dhe çdo dokument tjetër që duhet kryer në përputhje me këtë të fundit.

- "ALBAVIA" sh.p.k nuk është në një proces falimentimi (apo procese të tjera të ngjashme), në shkrirje ose në proces likujdimi.

Deklarimet dhe Garancite e " Emuliv"sh.p.k:

- EMULIV sh.p.k dhe perfaqësuesi i saj ka të gjithë fuqinë dhe autoritetin e kërkuar për të kryer këtë marrëveshje dhe çdo dokument tjetër që duhet kryer në përputhje me këtë të fundit.

- EMULIV sh.p.k nuk është në një proces falimentimi (apo procese të tjera të ngjashme), në shkrirje ose në proces likujdimi.

Neni 15

ZGJIDHJA E MARRËVESHJES

Kjo marrëveshje mund të përfundojë në çdo kohë para Datës së Mbylljes me aprovimin me shkrim të të dyja paleve.
Kjo marrëveshje mund të përfundojë nga secila palë me anë të njoftimit me shkrim te pala tjetër, para Datës së Mbylljes, nëse bashkimi nuk përfundon.

Neni 16

KONFIDENCIALITETI

Palët do të trajtojnë në mënyrë konfidenciale të gjitha informacionet e marra dhe të përftuara si rezultat i nisjes dhe përmbushjes së kësaj Marrëveshje, të cilat kanë lidhje me negociatat, për mbushjen dhe mbylljen e kësaj marrëveshje ose të çdo dokumenti që referohet nga kjo marrëveshje.
Palët mund t'i japin informacion një pale të tretë, i cili mund të konsiderohet konfidencial nëse:

a) Kërkohet nga ligji ose me qëllim të ndonjë procedure ligjore.
b) Kërkohet nga ndonjë institucion qeveritar.
c) Me miratimin parapark me shkrim të palës tjetër.

Neni 17

LIGJI I ZBATUESHËM

Kjo marrëveshje rregullohet në të gjitha aspektet nga ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 18

TË PËRGJITHSHME

Kjo Marrëveshje bashkimi dhe Raporti do të depozitohen sipas ligjit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, jo më vonë se 1 muaj përpara datës së caktuar për mbledhjen e Asamblesë, për marrjen e vendimit të përcaktuar në nenin 218 të ligjit 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", duke publikuar edhe pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë e dokumentet publikohen, në mënyrë të detyrueshme, për të paktën tri vitet e fundit.

Autorizohet Gentian Bala, të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për depozitimin e të gjitha akteve për realizimin e kësaj procedure të bashkimit me përthithje.

Neni 19

TË NDRYSHME

a) Të gjitha komunikimet, njoftimet dhe shpalljet e kërkuara apo dhe të lejuara nga kjo marrëveshje do të dorëzohen dorazi ose me anë të postës në adresën si më poshtë vijon, derisa Palët të njoftojnë njëri-tjetrin për ndryshime të adresave të tyre.

b)

Për ALBAVIA sh.p.k :

Tiranë, Rruga Sulejman Delvina,Pallati. Fati,shk.1,ap.19
Në vëmendje të:
Z. Shkëlqim Rakipaj dhe Z. Hasan Hafizi

Për EMULIV sh.p.k:

Kamez, Lagjja nr.4, numer pasurie 47/49, (prane Argjinatures)

Në vëmendje të: Z. Shkëlqim Rakipaj

c) Ndryshime

Asnjë ndryshim i kësaj Marrëveshje nuk do të jetë i vlefshëm përvecse me shkrim dhe e nënshkruar nga palët.

Kjo marrëveshje u hartua sot më datë 14 Dhjetor 2020 , në 4 kopje orgjinale dhe u nënshkrua nga:

PALËT

Shoqëria
ALBAVIA sh.p.k
Përfaqësuar nga:

ALBAVIA Shpk. NIPT J015270010

Shkëlqim Rakipaj
Administrator

Hasan Hafizi

Shoqëria
EMULIV
Përfaqësuar nga:

EMULIV sh.p.k.
RR. "VASO PASHA" PALL. 26
KODI FISKAL: 3709130
NIPT: K11821005V
TIRANE

Shkëlqim Rakipaj
Administrator

RAPORT

I BASHKIMIT ME PËRTHITHJE TË SHOQËRISE

"EMULIV" SH.P.K NGA SHOQËRIA "ALBAVIA" SH.P.K

ALBAVIA

